



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 168/25 Dt. 10.03.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2016”, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2024 për Administratë të Hapur në Komuna dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për organizimin dhe planifikimin e dëgjimeve buxhetore për Komunën e Prizrenit për vitin 2026-2028. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:
 - 1.1. Lulzim Sulejmani,.....kryesues i grupit,
 - 1.2. Halil Lika,zv. kryesues i grupit,
 - 1.3. Gjafer Ponik,.....anëtar, procesmbajtës,
 - 1.4. Ymer Berisha,.....anëtar,
 - 1.5. Haziz Krasniqi,.....anëtar,
 - 1.6. Besarta Caka,.....anëtare,
 - 1.7. Fejsal Hoti,.....anëtar,
 - 1.8. Shaban Krasniqi,anëtar,
 - 1.9. Fisnik Minci,.....anëtar.
2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi ndër të tjera janë edhe:
 - 2.1. Identifikimi i grupeve të qytetarëve përmes përdorimit të bazës së të dhënave komunale të grupeve të interesit, përgatitja e planit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin vjetor të Komunës së Prizrenit, duke përfshirë në mes të tjerash përcaktimin e numrit të dëgjimeve buxhetore, vendit dhe kohës, etj., përgatit materialet që janë të nevojshme gjatë dëgjimeve buxhetore, si: ftesa të personalizuara, (nëse konsiderohet e nevojshme) apo ato që publikohen në ueb faqe e rrjete sociale të Komunës, modelin e procesverbalit të

takimit, listën e pjesëmarrësve, etj.,. Përgatit informacione për buxhetin që do ti prezantohen qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore (përfshirë buxhetin ne dispozicion për projekte të reja), në një format të vizualizuar dhe lehtë të kuptueshëm për qytetarët.

- 2.2. Prezantimi i informacioneve të buxhetit (me theks të veçante në paraqitjen transparente të buxheteve të disponueshme për konsultim me qytetarët për projekte të reja nga kategoria e investimeve kapitale, ndarja e listave të pjesëmarrësve për nënshkrim, mbajtja e procesverbaleve të takimit, moderimi dhe fasilitimi/lehtësimi i dëgjimit buxhetor (me theks të veçantë në nxitjen e diskutimit dhe pranimin e ideve dhe kërkesave nga qytetarët, e po ashtu në nxitjen e validimit të kërkesave të qytetarëve nga komuniteti i pranishëm në dëgjim buxhetor, sidomos atyre që në bazë të argumentimit konsiderohen se janë prioritare dhe urgjente për tu realizuar).
 - 2.3. Përpilimi i kriterëve/arsyeve për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe kategorizimit e prioritizimit për pranimin dhe refuzimin e tyre, Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të pranuar gjatë dëgjimeve buxhetore dhe të tjera që pranohen me shkrim (rrjete sociale, email, ueb faqe) apo forma të tjera si takime të rregullta me Kryetarët apo të ngjashme, hartimi i një raporti të detajuar të konsultimeve publike ku evidentohen dhe elaborohen të gjitha kërkesat e pranuar të qytetarëve dhe jo vetëm ato të pranuar fizikisht gjatë dëgjimeve buxhetore, publikimi i raportit të konsultimeve publike në faqen e internetit të komunës dhe sipas kërkesave dhe afateve kohore të Udhëzimit Administrativ për Administratë të hapur.
3. Obligohet Grupi Punues dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Grupit Punues,
- Arkivës së Kryetarit.

